



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2024:013318

Datë: 20.06.2024

Numri i dokumentit: 05839176

C.nr.58/2024

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEGA NË PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**, me gjyqtarin Binak Duqi dhe bashkëpunëtorin profesional Mensur Avdullahu në çështjen juridike kontestimore të paditëses Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike SH.A (KEDS), me seli në adresën: Bulevardi Bill Klinton nr.5 - Prishtinë, kundër të paditurës F... R... S... ish nga fshati P... K... e P... e tani me vendbanim në P... në Rr: "S... D...", nr.... T..., me objekt kontesti Kompensim dëmit material, me vlerë të kontestit: **91.93 €uro**, jashtë seance me dt. 20.06.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**- pa shqyrtim kryesor të çështjes -**

**I. REFUZOHET** në tërësi padia dhe kërkesëpadia e paditëses Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike SH.A (KEDS) me seli në Prishtinë, **si e pabazuar**, me të cilën ka kërkuar që të:

**"APROVOHET** padia dhe kërkesëpadia e paditëses Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike SH.A (KEDS) me seli në Bulevardi Bill Klinton nr. 5 - Prishtinë, si e bazuar në tërësi dhe:

**OBLIGOHET** i padituri F... R... S... nga fshati P... K... e P..., që t'ia paguaj paditëses Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike SH.A (KEDS) me seli në Bulevardi Bill Klinton nr.5 – Prishtinë, dëmin e shkaktuar material në shumë prej 91.93 €uro, dhe atë me kamatë ligjore duke filluar nga dita e ushtrimit të padisë e gjerë në pagesën definitive si dhe shpenzimet e këtij kontesti, të gjitha në afat prej 15 ditësh nën kërcënimin e përmbarimit."

**II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

**A r s y e t i m**

Paditësja, me datën 15.01.2024, ka ushtrua padi në këtë gjykata, me të cilën ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet kërkesëpadia dhe të detyrohet e padituri që në emër të dëmit të shkaktuar material, paditëses t'ia paguajë shumën prej 91.93 €uro. Ka shtuar se i padituri me qellim që vetes ti sjell pasuri të kundërligjshme ka shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyre të paautorizuar, ashtu që ka

bere lidhje direkte ne rrjetin e tensionit te ulet duke e anashkaluar njehsorin elektrik dhe duke shpenzuar energjinë elektrike pa matje. Me veprimin e tij, i padituri i ka shkaktuar Paditësit demin material ne vlere prej 91.93 €. Ka theksuar se sipas Aktgjykimit Penal te formës se Prere te Gjykatës Themelore ne Prishtine P.nr.2247/18 te datës 12.12.2023, i padituri ishte shpallur fajtor për shkak te veprës penale “ Vjedhja e Shërbimeve” nga neni 314 par.1 lidhur me par 4 dhe 6 te KPRK – së, përderisa e dëmtuara, tani paditësi për kompensimin e demit te shkaktuar ne lidhje me veprën e lartpërmendur penale është udhëzuar ne kontest civil.

I ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave ta aprovojë kërkesëpadinë. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura në përgjigje në padi e ka kontestuar kërkesëpadinë ne tërësi, duke theksuar ndër të tjera se e pretendimet e paditësit Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike SH.A (KEDS) se e paditura e lartcekur kane kryer aktin e vjedhjes se shërbimeve nuk qëndrojnë dhe nuk ekziston asnjë prove e vetme ku e njëjta është dënuar për demin shkaktuar, po ashtu edhe po te kishte qene e vërtet tashme kane kaluar 7 (shtatë) vite dhe ky borxh ish dashur te parashkruhet, andaj padia është ne kundërshtim me Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve Ligji Nr. 04/L-077. Ka shtuar se padia e parashtruar nga paditësi është ne kundërshtim me ligjin për Procedurën Kontestimore Ligji Nr. 03/L-006 përkatësisht neni 253 par.1 a) dhe b) pasi qe me asnjë prove te vetme nuk e mbështet padinë. Shton se në rastin konkret thëniet e paditësit nuk qëndrojnë për arsye se me asnjë prove te vetme se ka dëshmuar, dhe se deklaroj me përgjegjësi te plote penale dhe morale se nuk është e mundur qe e njëjta te ketë kryer veprën penale.

Në fund ka shtuar se jeton e vetëm me ndihme sociale dhe e ka te pamundur te paguaj borgjin. Andaj, nga të cekurat i ka propozuar gjykatës që të refuzohet në tërësi kërkesëpadia e paditëses si e pabazuar.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata, pas pranimit të përgjigjes në padi, ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës të përcaktuara në nenin 399 të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK-së), sepse nga përgjigja në padi rezulton qartas se kërkesëpadia e paditësit është e pathemeltë.

Gjykata, pas vlerësimit të pretendimeve të palës së paditur të parashtruar përmes përgjigjes në padi, ka gjetur se nuk është kontestuese se vepra penale për të cilën është ngritë aktakuzë ndaj të akuzuarës - të paditurës F... R... – S... ka ndodhur me datën ..., e cila aktakuzë në procedurën penale është hedhur dhe është pushuar procedura penale komform dispozitave ligjore të Kodit Procedurës Penale dhe Kodit Penal të aplikueshëm në rastin konkret, për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale ndaj të akuzuarit këtu të paditurës me aktvendimin P.nr.2247/2018 të datës 12.12.2023 të Gjykatës Themelore të Prishtinës, për veprën penale Vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së.

Gjykata, në kuptim të rrethanave të konstatuara me lart dhe duke e vlerësuar prapësimin e të paditurës në lidhje me parashkrimin e kërkesës, gjeti se kërkesa është e parashkruar.

Me dispozitën e nenit 358 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve NR. 04/L-077–LMD-së, për kërkesat e natyrës së tillë është paraparë afati i parashkrimit ashtu që: “Kur dëmi është

*shkaktuar me veprë penale dhe për ndjekjen penale është parashikuar një afat më i gjatë parashkrimi, kërkesa për shpërblim të dëmit ndaj personit përgjegjës parashkruhet kur të skadojë koha e caktuar për parashkrimin e ndjekjes penale”, paragrafi 2 i te njëjtit nen: “ Ndërprerja e parashkrimit të ndjekjes penale sjell edhe ndërprerjen e parashkrimit të kërkesës për shpërblimin e dëmit ” i cili afat në rastin konkret ka kaluar para se të jetë ngritur padia dhe atë nga data e ndodhjes së ngjarjes-kryerjes së veprës penale dt.02.12.2017 parashkrimi i ndjekjes penale ka arritur me datë 02.12.2023, me çka është parashkruar dhe kërkesa për shpërblimin e dëmit.*

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet e palëve dhe provat tjera të ofruara, por vlerësoi se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të çështjes kontestimore, nga ajo siç është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është bazuar në dispozitat e neneve 449 dhe 450 të LPK-së, ashtu që gjykata vendosi që secila palë ti bartë shpenzimet e veta procedurale.

Nga arsyet e cekura me lart dhe bazuar në dispozitat e nenit 399 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**Gjykata Themelore në Prishtinë, Dega në Podujevë, Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr.58/2024, me datën 20.06.2024**

**Gjyqtari:**  
Binak Duqi

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.